




Fundi i Europës së krishterë apo fundi i fesë?

Description



Në Europë feja tanimë perceptohet gjerësisht si problem, sigurisht jo në gjirin e vetë komuniteteve të besimit. Sikurse e kemi diskutuar tjetërkund, ka tre fronte të dallueshme në këtë betejë. Së pari, sekularistët e linjës së ashpër: Për ata, feja është në vetvete e neveritshme, por fokusi i tyre sot është mbi kërcënimin që parashtron Islami, dhe jo mbi Kishën. N dërkohë që ky front sekular e sheh Selefizmin si armikun e tyre numër një, ka të ngjarë që ai të mos jetë dashamirës ndaj kortezheve të priftërinjëve dhe djelmoshave të altarit të veshur me petka të bardha dhe që mbajnë në duar kryqe të mëdha druri, apo ndaj judejve ortodoksë të cilët mbajnë krelat anësore (*payot*) nëpër rrugët e kryeqyteteve evropiane. Më pas vijnë *identitarianët*, për të cilët Krishterimi është pazgjidhshmërisht i lidhur me identitetin e Europës, por për aq kohë sa nuk ndërhyjnë në jetën e tyre të përditshme, nuk u mban atyre leksione se si të duan fqinjin e tyre, apo nuk u predikon atyre në lidhje me etikën dhe vlerat. Në fund, sigurisht, janë vetë komunitetet fetare, të cilët besojnë se feja e tyre (po r jo ajo e të tjerëve) është pjesë e zgjidhjes dhe jo problemi. Peshkopët francezë, për shembull, çmojnë parreshtur *laicitetin* francez, dhe madje në njëfarë pike janë ofruar edhe si vullnetarë që këtë koncept t'ua

mësojnë myslimanëve.[\[1\]](#)

Islami: Një akslerator i ndryshimit fetar në Europë

Gjatë tridhjetë viteve të fundit, që kur polemika e parë e “shamisë islamike” shpërtheu në Francë në vitin 1989, marrëdhënia e Europës me Islamin ka dominuar për dy arsye diskutimin rreth fesë. E para ka të bëjë me imigrantët myslimanë të gjeneratës së dytë, të cilët kanë lindur në Europë. Shumë prej tyre kërkojnë që Islami të pranohet në sferën publike, ndonëse në forma mjaft të ndryshme nga njëra tjetra. Arsyeja e dytë lidhet me shfaqjen e Islamit politik në Lindjen e Mesme, duke filluar me Revolucionin Iranian të vitit 1979 dhe ndjekur nga ngritja e lëvizjeve islamiste, si Vëllazëria Myslimane, dhe përhapja e terrorizmit “të globalizuar” nëpërmjet Al-Kaedës dhe Shtetit Islamik ISIS. Revolucioni Islamik i Iranit la një gjurmë të thellë në mendjet perëndimore, por pati impakt të vogël mbi myslimanët evropianë, ndërkohë që fenomeni i radikalizimit politik dhe fetar në mbarë botën sunite ka patur pa dyshim efekte për atë që sot është një Islam i globalizuar.[\[2\]](#)

Synimi këtu nuk është që të diskutohet “çështja islame”, mbi të cilën ka patur diskutime dhe studime të shumta, por që të shqyrtohen lidhjet ndërmjet rregullimit të Islamit dhe çështjes fetare në përgjithësi. Megjithatë, unë jam i bindur se, sikundërse tregon ky libër [ky është një fragment nga libri i autorit, sh.p.], kur vjen puna tek çështja fetare, ne merremi me tendenca afatgjata që pararendin shfaqjen e çështjes islame.

Kohët e fundit në Europë ka patur disa çështje rreth fesë, të mbarsura këto me polemika, të cilat në pamje të parë nuk kanë asnjë lidhje me Islamin; për shembull, çështja e kryqeve në Itali. E megjithatë, duke qenë se çështjet fetare në përgjithësi trajtohen në kornizën e “modalitetit të krizës”, ato priren që të gjejnë zgjidhje nga parlamentet dhe gjykatat (në fund, nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut ECHR) nën një trysni të fortë nga opinioni publik i mobilizuar përreth rasteve specifike. Hipoteza ime është se rregullimi i Islamit nga gjykatat përbën riformësim të të gjithë skenës fetare në Europë, dhe, për këtë arsye, çon në rimendim të Krishtëritimit, prej kohësh i shtyrë në margjina nga sekularizmi dhe kriza e brendshme e Kishës Katolike. Çështja këtu është nëse janë apo jo “islamofobe” (ky term është tejet i mjegullt për të qenë vërtet i dobishëm) vendimet e marra nga Gjykata Europiane dhe tribunale të tjera. Synimi është që të studiohet impakti i tyre mbi marrëdhënien e Europës me Krishtërimin. Ç’është e vërteta, ky impakt është negativ për Krishtërimin, për shkak se ai mohon relevancën e fesë në përgjithësi.

Në fakt, të gjitha vendimet lidhur me Islamin kanë pasojë edhe për Krishtërimin, dhe madje edhe më tepër për Judaizmin. Ligjet e miratuara nga parlamentet e vendeve evropiane dhe vendimet egjykatave gjegjëse (të mbështetura nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut) ndahen në dykategoritë. Së pari, kemi ato që vendosin rregulla më kufizuese në lidhje me praktikën fetare nëpërgjithësi, madje edhe në qoftë se objektivi i tyre parësor është që të vendosen kufizime mbi Islamin. Këtu kemi kufizimin e ekspozimit të dukshëm të të gjitha simboleve fetare në pjesë të ndryshme të sferës publike, dhe vendosjen e ndalimeve mbi rrethprerjen dhe prerjen rituale të kafshëve. Së dyti, kemi ato që përforcojnë apo afirmojnë përparësinë e një identiteti të krishterë që është esencialisht kulturor (ajo çka gjykatat gjermane e kanë emërtuar si *Leitkultur*): ruajtja e simboleve të krishtera në hapësirat publike, duke përjashtuar kështu të gjithë të tjerët (në Itali dhe Bavari), ndalimi i minareve në Zvicër, dhe kështu me radhë. Por të dyja këto lloje të politikave kufizuese hasin një sfidë të njëjtë: ato janë të detyruara që të respektojnë lirinë fetare. Si mund të pajtohen sekularizimi dhe liria fetare? Si mund të pajtohet njohja e Krishtërimin si fe shumicë me lirinë për fetë e tjera?

Pavarësisht nga diversiteti i tyre, të gjitha kushtetutat evropiane pajtohen *de facto* mbi një numër pikash që kanë të bëjnë me fenë. Ato të gjitha e njohin lirinë fetare, që nuk nënkupton vetëm të drejtën për të mos u diskriminuar për "identitetin" tënd (si për racën dhe gjininë) apo thjesht të drejtën e gëzimit të lirisë së besimit (si në rastin e një opinioni politik apo filozofik), por që gjithashtu përfshin të drejtën për të praktikuar fenë. Ligji më kufizues në Europë, Ligji i vitit 1905 në Francë për Ndarjen e Kishës nga Shteti, është mjaft i qartë: ai nuk përzihet në çështjet e fesë (pikërisht sepse ka ndarje) apo në besimin individual (i cili i përket sferës private), por ka të bëjë me "adhurimin": me fjalë të tjera, me praktikën fetare. Ndërkohë që vendos limite mbi praktikën fetare, Ligji i vitit 1905 organizon se si kjo praktikë manifestohet në sferën publike (ndërtesat, kortezhet, postet e kapellanëve, simbolet fetare, këmbanat, lutja në publik, liria për të praktikuar fenë, përjashtimet ligjore siç është vula sakramentale apo sekreti i rrëfimit, etj...). Ai ligj nuk ndalon në asnjë mënyrë mbajtjen veshur të simboleve fetare në hapësirat publike; priftërinjtë që kanë mbajtur gjithashtu edhe poste publike si politikanë, si Abbe Pierre dhe Canon Kir, të dy të zgjedhur në post zyrtar shumë kohë më pas vitit 1905, nuk e kanë pasur kurrë të ndaluar që të veshin rasë në parlament (ndërkohë që për shumë vite, parlamentaret femra nuk e kishin të lejuar që të vishnin pantallona).

Këtu duhet të bëjmë një sqarim: parlamentet dhe gjykatat nuk kanë certifikuar asnjëherë barazinë e feve, por vetëm kanë parashkruar kufizime mbi lirinë e praktikës fetare (dhe lirisë së shprehjes). Ndonjëherë ato mund të afirmojnë të drejtën për të ekspozuar simbolin e një feje të veçantë (Krishtërimin në këtë rast) në kurriz të feve të tjera, në qoftë se e para korrespondon me një "kulturë". Në mënyrë të ngjashme, asnjë komunitet fetar nuk ka kërkuar barazinë e feve; ato thjesht duan respektim të praktikave (kosherin, për shembull) dhe besimet e tyre (për të krishterët, e drejta për përjashtime mbi bazën e ndërgjegjes, për shembull, në lidhje me kryerjen e aborteve apo martesave mes të njëjtës gjini, apo largimi nga puna i mësuesve të shkollave private katolike të cilët martohen rishtazi mbas divorcit).

Në fakt, respektimi i lirisë fetare jo domosdoshmërisht nënkupton trajtim të barabartë të feve. Ka religjione që mund të jenë feja zyrtare e shtetit (si në Danimarkë dhe në Mbretërinë e Bashkuar) ose ka nga ato që mund të kenë një status të veçantë (siç është regjistri automatik i martesave katolike nga gjendja civile italiane, apo statusi ligjor i Krishtërimin dhe Judaizmit si korporata statutoire në Gjermani). Por, në një ikje nga shteti i konceptuar sipas Traktatit të Vestfalisë, sot asnjë shtet nuk mund të imponojë një fe apo të interferojë në debatet teologjike. Shtetet as nuk mund të mbrojnë ndonjë formë

të prozelitizimit fetar. Në këtë drejtim, të gjitha shtetet janë asnjëanëse, përfshirë edhe ato që kanë një konkordat me Selinë e Shenjtë. Kjo do të thotë se – përkundër asaj që mund të besojnë ultra-sekularistët francezë – zyrtarët e qeverisë mund të marrin pjesë në evenimentet fetare pa sinjifikuar kjo mbështetje për atë fe përkatëse, por kjo për sa kohë që ata nuk përkrahin përhapjen e një mesazhi fetar. Shtetet mund të përdorin simbole të krishtera, siç është kryqi, por kjo duhet të jetë për arsye pastërtisht kulturore, dhe jo me ndonjë qëllim për të prozelitizuar (kryqet në flamurin britanik, ato skandinave dhe atë zvicerian, për shembull, nuk kanë asnjë lloj mesazhi misionar).

Por ndarja midis teologjikes dhe politikes operon në të dyja kahjet. Një qytetare franceze nuk mund të padisë Kishën Katolike, në emër të barazisë mes burrave dhe grave të garantuar nga kushtetuta e vendit të saj, nëse Kisha refuzon që ta pranojë atë në seminar – të paktën, jo për momentin. Këto çështje ilustrjnë se çfarë ka rëndësi këtu, sikundërse kemi për ta parë më poshtë më në hollësi.

Shteti nuk mund të interferojë në punët e teologjisë, si për shembull në interpretimin e një verseti të Biblës apo të një ajeti të Kuranit, por vetëm në veprimet e njerëzve që mund të pretendojnë frymëzim prej tij. Kështu, askush nuk mund të flijojë birin e tij apo të saj për Zotin, duke pretenduar se ka patur një revelatë, por ama vetë Revelatave u është dhënë imunitet. Hapësira e vetëm për manovrim nga ana e gjykatave është që të vendosë nëse mbrojtja e fesë (apo dhe e kulturës) cilësohet një faktor lehtësues apo agravues. Sipas intuitës sime (gjë e cila lips konfirmim nga hulumtimet në jurisprudencë), nga vitet 1990 deri në vitet 2010, ka patur një zhvendosje nga e para tek e dyta. Sido që të jetë, kjo është qartësisht e vërtetë për sa i përket gjymtimit gjenital femëror (FGM) për sferën kulturore dhe rrethprerjes për religjosen.

Përshpjëtimi i sekularizimit të Europës nga ana e Gjykatave

Le të marrim në shqyrtim një numër rastesh gjyqësore të pesëmbëdhjetë viteve të fundit të cilat tregojnë tendencat e gjera në ligjin europian.

Ligjet mbi simbolet fetare

Disa vende kanë miratuar ligje për të kufizuar mbajtjen e veshjes islamike. Në të gjithë Europën ka patur një tendencë në rritje për të ndaluar burkën, që nuk paraqitet kurrë si shprehje e një praktike fetare (kryesisht për shkak se ajo është një zgjedhje personale dhe jo një obligim teologjik). Pikë së pari, burka është ndaluar mbi bazën e argumenteve të sigurisë dhe për arsyet e “të jetuarit së bashku”, duke shmangur në këtë mënyrë çështjen fetare.

Sa i përket shamisë myslimane, natyra e saj fetare nuk ka të mohuar: teologë të shumtë myslimane e cilësojnë atë si një obligim. Duke qenë se shteti nuk mund të përcaktojë interpretimin e saktë të Kuranit, ai duhet të pranojë se hixhabi është përnjimend simbol fetar. Kjo i ka dhënë hov dy tipeve të legjislacionit: ose hixhabi ekskluzivisht konsiderohet se përbën problem, ose vendi i të gjithë shenjave fetare duhet të rivlerësohet. Franca zgjodhi këtë të dytën në vitin 2004 kur u miratua një ligj që ndalonte të gjitha simbolet fetare në shkollat publike. Kjo çështje nuk ishte shfaqur më herët. Ndërkohë që simbolet e kirishtera apo judaike ishin të rralla, ato toleroheshin, dhe asnjëherë nuk përkufizoheshin me qartësi. Ligji i shamisë nuk trajton barazinë e feve, por çështjen e shenjave fetare në përgjithësi.

Me përjashtimin se, krejt papritmas, të gjitha simbolet fetare janë hequr nga hapësira të caktuara publike në Francë: rasa e kapelanitkatolik (e cila, me thënë të drejtën, praktikisht ishte zhdukur prej kohësh), kipah judaike, turbanët sikh – madje, sipas ministrit Luc Ferry, edhe “kryqet e mëdha asiro-

kaldeane” (në qoftë se kryqet të tilla kanë ekzistuar vërtet).^[3] Dhe ç’është e vërteta, etapa e radhës në sekularizimin e sferës publike është duke u përmbushur.

Tipi i dytë i vendimit ligjor mbi shaminë (në Gjermani dhe Zvicër) ndalon specifikisht vellon, apo perçen, islame në ndërtesat zyrtare shtetërore dhe refuzon që këtë ndalim ta shtrijë tek shenjat e krishtera, duke argumentuar se Krishtërimi është pjesë e kulturës dominante (*Leitkultur*). Këtu, problemi parashtrihet ndryshe: sipas cilit parim mund të mbrohen simbolet e krishtera?^[4]

Rrethprerja

Më 7 maj të vitit 2012, në një çështje kundër një mjeku i cili kishte kryer një rrethprerje tek një fëmijë nga një familje myslimane, gjykata e rrethit në Këln të Gjermanisë vendosi që rrethprerja tek meshkujt përbën lëndim fizik të rëndë, madje edhe në qoftë se kryhej nga një mjek, nëse kjo nuk bëhej për arsye mjekësore. Dy argumente u paraqitën për të justifikuar këtë vendim: rrethprerja është: 1) një dhunim i integritetit fizik të fëmijës; dhe 2) një shkelje të drejtës së tij për liri fetare, pasi ajo i imponohet fëmijës si një shenjë e pakthyeshme fetare të cilën ai nuk ka qenë në gjendje që ta zgjedhë. Argumenti i parë angazhohet me një konflikt klasik midis të drejtave konkurruese: liria fetare dhe integriteti fizik. Por e dyta është më origjinale dhe shumë më domethënëse, për shkak se ajo e vendos lirinë fetare të fëmijës kundër asaj të prindërve: “Trupi i fëmijës ndryshohet në mënyrë të pandreqshme dhe të përhershme nga një rrethprerje. Ky ndryshim bie ndesh me interesat e fëmijës për të marrë më vonë vendime mbi besimet e tij fetare.”^[5]

Liria fetare këtu përkufizohet si ngushtësisht individuale: Fëmija duhet të lejohet që të rritet pa u indoktrinuar nga një fe e caktuar, e cila duhet të jetë vetëm njëri nga opsionet. Pas mbrojtjes së lirisë fetare shtrihet një ripërkufizim i asaj se çfarë është feja – nuk është më as traditë e as bashkësi, por një zgjedhje midis disa mundësive të shumta. E thënë thjesht, liria fetare mund të ushtrohet vetëm në një mjedis të sekularizuar dhe fetarisht të sterilizuar, në mënyrë të atillë që zgjedhja e një personi në moshë madhore nuk duhet t’i nënshtrohet asnjë trysnie apo shtrëngimi.

Pa dyshim, rrethprerja mund të denoncohet mbi bazën e argumentit të parë. Megjithatë, duhet pranuar se argumenti i dytë e privon fenë nga çdo dimension hyjnor apo historik. Ai dështon që të afirmojë asnjëanësinë e shtetit në punët e fesë, dhe në vend të kësaj instalon relativizmin si doktrinë zyrtare. Kisha Katolike e rroku menjëherë fillin e çështjes: Kardinali arqipeshkv i Këlnit, Joachim Meisner, tha se vendimi i gjykatës po krijonte një ‘detyrë shtetërore për të mbrojtur fëmijët kundër zgjedhjes së prindërve të tyre’.^[6] Këtu sërish, ne i jemi kthyer debatit në lidhje me modelin e familjes.

Në vijim të kundërshtimit nga bashkësia judaike, vendimi u anulua nga një ligj që u miratua në Bundestag (nuk duhet harruar se një nga vendimet e para të regjimit nazist ishte ndalimi i rrethprerjes dhe prerjes rituale të kafshëve). Megjithatë, kjo nuk e bën vendimin fillestar krejt pa vend, duke qenë se parlamenti nuk kontestoi argumentimin e gjykatës. Parlamenti mori një vendim politik dhe jo juridik duke theksuar se bashkësitë judaike dhe myslimane nuk duhet të pengohen që të jetojnë në Gjermani. Por në vende të tjera që nuk u janë nënshtruar kësaj censure politike, fushatat kundër rrethprerjes dhe prerjes rituale të kafshëve janë në shkullm. Islanda e ndaloi rrethprerjen në vitin 2018, dhe një ndalim i mundshëm është duke u shqyrtuar seriozisht në vendet skandinave.

Prerja rituale e kafshëve

Më 17 shkurt të vitit 2018, Danimarka ndaloi (apo reduktoi, sipas variantit zyrtar) procesin e prerjes

rituale për mishin kosher dhe hallall. Argumenti i përdorur është ai i vuajtjes së kafshëve, duke i dhënë hov një konflikti klasik të të drejtave, në të cilin drejtim ministri danez i bujqësisë, Dan Jorgensen, thuhet se ka pretenduar që “mirëqenia e kafshëve është përpara fesë”.^[7] Kjo nuk duhet parë thjesht si një shprehje e hollë e anti-semitizmit apo Islamofobisë (ndonëse pikërisht ky është motivimi i një pjese të atyre që janë në mbrojtje të ndalimit). Lëvizja e të drejtave të kafshëve po përhapet në mbarë Europën, dhe po bëhet gjithnjë e më radikale, ndërsa ka filluar të sulmojë kasapët hallall e jo-hallall pa dallim, por edhe laboratorët farmaceutikë, gjuetarët, punishtet e gëzofëve, dhe mish-ngrënësit në përgjithësi.

Këtu, sërish, po përvijohet një ndryshim antropologjik vendimtar. Po vihet në diskutim hierarkia e të drejtave natyrore duke rrëzuar dallimin mes njeriut dhe kafshës, dallim ky që ka pasur rrënjë dukshëm të thella përgjatë gjithë traditës së krishterë dhe asaj perëndimore. Perëndia i Zanafillës i krijoi kafshët përpara njeriut, por ai i porositi dy herë Adamin dhe Evën që të sundonin mbi to.^[8] Dekarti pohonte se njeriu dhe kafsha janë të diferencuara nga aftësia e njeriut për të menduar – *cogito*. Antropologjia moderne ka përkufizuar se kultura lind nga shkëputja prej natyrës.

Shkrirja e këtij kufiri ecën krah për krah me përdorimin në rritje të evolucionit dhe etologjisë (studimi i sjelljes sociale të kafshëve) në përligjjen e praktikave njerëzore, që nga monogamia e deri te poligamia dhe madje edhe deri te përdhunimi, duke flakur kësodore tutje debatin mbi vlerat. Ai gjithashtu përkon me hulumtimet lidhur me inteligjencën artificiale që punojnë për të krijuar qenie autonome që janë të afta të arsyetojnë, dhe që do të shiheshin si të pavarura nga njerëzit.

“Njeriu nuk është as ëngjëll as kafshë,” ka thënë Paskali. Sot hierarkia e tij po shembet, teksa njerëzit po humbasin pozitën e tyre midis kafshës me dinjitet dhe ëngjëllit të ftohtë të algoritmeve. Shpërbërja e këtij rendi natyror është një tjetër zgjerim i sekularizimit.

Blasfemia

Organizatat islamike dhe të krishtera kanë bërë përpjekje që të ndalojnë vepra dhe punime të caktuar argumentin e “blasfemisë”. Nocioni i blasfemisë, apo fyerjes ndaj Zotit, shpërfaq dy rende krejtësisht të ndryshme: të shenjtën dhe profanen. (Me përkufizim, nuk është e mundur që të bëhet blasfemi ndaj profanes, por vetëm ta fyesh apo ta tallësh). Duke qenë se vendet sekulare nuk e pranojnë këtë hierarki, legjislacioni në këto vende nuk mund të adoptojë nocionin e blasfemisë. Në vijim të çështjes së *Vargjeve Satanike*, një roman nga Selman Rushdiu i botuar në vitin 1988 që çoi në demonstrata të dhunshme dhe në një fetva që e dënonte me vdekje Rushdiun, ato pak vende evropiane që kishin ende ligje që ndalonin blasfeminë – ndonëse, ligje të tilla nuk ishin përdorur prej kohësh, si në Mbretërinë e Bashkuar – nxituan që të shfuqizonin nenet në fjalë.

Mjaft çuditërisht, ka patur raste kohët e fundit, madje edhe në Francën ultra-sekulare, ku janë përfshirë edhe gjykatat. Rasti më interesant, i cili nuk u rrëzua nga Gjykatata e Kasacionit për shkak se nuk u bë asnjë apelim, është ankesa e paraqitur nga një organizatë katolike kundër kompanisë së modës Marithe et François Gribaud në vitin 2005. Faktet janë të qarta: një kompani reklamash për firmat e veshjeve vendosi postera në rrugët e Parisit me një skenë që ishte një parodi e pikturës së Leonardo da Vinci-t, *Darka e Fundit* (1498), ku apostujt e Krishtit ishin zëvendësuar me vajza të veshura pak. Gjykatata e dënoi reklamën me arsyetimin e mëposhtëm:

Vendimi për të shfaqur këtë poster madhështor në zona publike është një *akt i panevojshëm dhe agresiv i ndërhyrjes në besimet më të thella të njerëzve...* Mendjelehtësia e skenës, për më tepër,

shkatërron të gjithë natyrën tragjike që është e qenësishme në ngjarjen e parë të Pasionit të Krishtit... Fyerja që i bëhet katolikëve është shumë më e madhe se qëllimi i dëshiruar komercial.

Dy vërjetje dalin në pah. Së pari, gjykata nuk tha se posterit ishte një parodi e da Vinci-t (që është sigurisht kështu, pasi piktura në fjalë është shumë më e mirënjohur se sa pasazhi në Ungjillin e Lukës), por se posterit ishte një parodi e Jezusit dhe e apostujve. Duke injoruar që Leonardo da Vinci është një artist i madh dhe se vepra e tij përkejt kujtdo, jo Kishës, përçohet, pra, një mohim i nënkuptuar i dimensionit kulturor të pikturës. Me fjalë të tjera, Kisha pak a shumë e pa të përshtatshme që t'i jepte vetes të drejtat e autorit të Darkës së Fundit, pra, mbi çdo paraqitje të institucioit të Eukaristisë, për shkak se ajo është një dogmë tesenciale. Në këtë mënyrë, vetë koncepti i kulturës së krishterë u mohua, me refuzimin e idesë se një element me origjinë fetare mund të zhvendoset në një kontekst kulturor profan ku besimtarët dhe jo-besimtarët pa dallim mund ta shijojnë atë pa u kërkuar atyre që të tregojnë certifikatën e tyre të pagëzimit. Kjo ka efektin që e rrënjos shkëputjen midis shënjesit fetar dhe shënjesit kulturor, duke qenë se heq mundësinë që të jenë njëkohësisht të dyja në një vepër. Shkurtimisht, gjykatat shërbejnë për të ratifikuar dekulturimin e sferës fetare, apo së paku për të dëshmuar një të tillë.

Por dimensionin e dytë është edhe më interesant. Gjukata nuk penalizoi fyerjen ndaj të shenjtës, domethënë, ndaj Krishtit (të cilin ajo nuk mund ta konsiderojë një subkejt të ligjit më shumë se sa Profetin Muhamed), por vuajtjen e shkaktuar mbi burrat dhe gratë fetare. Çështja nuk ka të bëjë me blasfeminë, por gjykata e sekularizon dimensionin e të shenjtës; ne nuk po flasim më për shkelje kundër të shenjtës, por për dëme që jepen për vuajtjen e individëve. Në linjë me vlerat e viteve 1960, kjo vuajtje cilësohet e papranueshme, duke qenë se individit ka të drejtë të jetë i lumtur, të ketë paqe të brendshme, dhe të thjeshtë të lihet rehat. Kjo është diçka mjaft e ndryshme ngasens i gjallë i tragjikes që gjejmë në Ungjill. Në këtë mënyrë, në këtë lloj gjykimi, gjykata sekularizon shpirtin.

Revokimi i imunitetit të klerit

Komunitetet e besimit të të gjitha bindjeve fetare nuk janë më në gjendje që të imponojnë mbi shoqërinë “çështjet e tyre morale të panegociueshme”. Si rrjedhojë, ato nuk pretendojnë përjashtime për arsye të ndërgjegjes, të cilat do t'u lejonin atyre që të mos jenë të detyruar të veprojnë në përputhje me obligime të caktuara statutores që janë në kundërshtim me besimet e tyre. Këto çështje vendosen nga gjykatat rast pas rasti, por në tërësi, sekularizmi po ndërhyr edhe aty. Edhe në SHBA, ku Gjukata Supreme mbajti anën e një furrтари nga Kolorado i cili refuzoi që të bënte një tortë dasme për një çift gay, nëpunësve shtetërorë u mohohet e drejta për të mos lëshuar licensa për martesat mes të njëtes gjini.

Mbrojtja që Kisha u ka bërë priftërinjve pedofilë dhe pengimi i mëpastajmë i hetimeve nga ana e saj kanë rezultuar me pasoja shkatërrimtare për autoritetin e saj. Jo vetëm që është rrënuar reputacioni dhe imazhi i saj (si mund të mbajë leksione mbi abortin dhe shenjtërinë e jetës kur mbulon abuzimin me fëmijët?), por gjithashtu skandalet kanë nxitur publikun dhe autoritetet që të sfidojnë aspekte të tëra të sferës fetare. Shembulli më i qartë i kësaj është në Australi, ku në qershor të vitit 2018 Asambleja Legjislative miratoi ligje që u kërkonin priftërinjve të thyenin vulën e sekretit të rrëfimit për rastet që kishin të bënin me abuzimin me fëmijët. Kjo masë ka sensitivitate të larta duke pasur parasysh ngurrimin e Kishës për të raportuar priftërinjtë fajtorë. Por, siç vihet në dukje nga arqipeshkvi i Kanberrës, Christopher Prowse, ajo është gjithashtu “një ndërhyrje në jetën sakramentale të Kishës,” [9] pasi rrëfimi është një kusht për marrjen e Eukaristisë dhe, rrjedhimisht, të shpëtimit. Në qoftë se një mëkatar nuk rrëfen nga frika se do të raportohet, atëherë vetë qëllimi i Kishës – garantimi i shpëtimit të

shpirtërave – vihet në rrezik. Disa mund të thonë se ky ndalim prek vetëm rastet e abuzimit seksual, por duke pasur parasysh kërkesën për transparencë në rritje në shoqëritë tona, lista e krimeve dhe keqbërjeve që revokojnë vulën e sekretit të rrëfimit me siguri që do të bëhet më e gjatë, derisa vetëm ata që bëjnë mëkatën e masturbimit do të shpësojnë që të gjejnë shpëtim të përjetshëm.

Në qoftë se, në këtë rast, Kishës nuk i ngelet tjetër vetëm se të fajësojë veten, rezultati është në linjë me hipotezën time në lidhje me zgjerimin e sekularizimit dhe dekrizianizimit në Perëndim. Në rastin e rrëfimit, fuqitë sekulare refuzojnë të marrin parasysh çështjen teologjike, që është në linjë me rolin e tyre. Por ka gjithnjë e më tepër situata në të cilat opinioni publik, kryesisht i dekrizianizuar, po kërkon që fuqitë sekulare të ndërhyjnë në teologji. Në vitin 2009, në qytetin Recife në Brazil, një vajzë nëntë vjeçare, e cila ishte përdhunuar nga njerku i saj dhe kishte ngelur shtatzënë me binjakë, iu nënshtrua abortit për arsye mjekësore. Arqipeshkvi i Recifes, Jose Cardoso Sobrinho (i emëruar nga Gjon Pali II në vitin 1985 për të zëvendësuar peshkopin progresist Dom Helder Camara) çkishëroi si nënën e vajzës ashtu dhe mjekun, por më vonë tërhoqi çkishërimin për nënën për shkak se (nën trysni nga prifti i famullisë) ajo pretendoi se kishte ndryshuar mendim në lidhje me dhënien e pëlqimit për abortin. Publiku reagoi duke shprehur zemëratë, aq më tepër që përdhunuesi nuk ishte çkishëruar. Arqipeshkvi më pas sqaroi se sipas ligjit kanonik, aborti, që për Kishën është vrasje, është shumë më i rëndë se përdhunimi. Kjo deklaratë shkaktoi një skandal. Shumë pjesëtarë të Kishës denoncuan mungesën e dhembshurisë së peshkopit, por e bënë këtë pa vënë në diskutim hierarkinë e mëkateve që ai kishte paraqitur në përputhje me ligjin kanonik. Kështu, janë shfaqur dy botë diametralisht të kundërta sa i përket vlerave. Debati publik mbi abortin është përsosmërisht normal, por debati mbi çkishërimin është shumë më befasues: përse shqetësohen jo-besimtarët lidhur me shpëtimin e shpirtit të dikujt? Përse të mos dënohet thjesht qëndrimi i Kishës ndaj abortit? Përse t'i kërkohej Kishës që të bëjë ndryshime në teologjinë e saj kur ai që bën kërkesën nuk është pjesëtar i saj? Përse kërkohej Eukaristia për të gjithë?

Ndërhyrje të tilla të sekulares në teologji prekin të gjitha fetë. Ndër judejtë praktikantë, *halakha* përcakton se një grua që kërkon divorcin duhet të marrë një leje të shkruar nga bashkëshorti i saj, dokumenti *get*, pa të cilin ajo nuk është e autorizuar që të martohet sërish. Gjykatat civile nuk duhet të merren me këtë problematikë, por megjithatë, madje edhe në Francë, ndonjëherë ato ndërhyjnë me arsyetimin e dëmit moral. Në të njëjtën kohë teksa nje peshën e fesë, kjo qasje gjithashtu e “zbut” dhe e psikologjizon atë, duke operuar nisur nga presupozimi se besimi në vetvete përbën pësim dëmi.^[10] Sa i përket Islamit, një peticion i kohëve të fundit në Francë bëri thirrje që ajete të caktuara të hiqeshin nga Kurani, sigurisht pa kërkuar heqjen e verseteve të ngjashme në librat e Eksodit apo Levitikut.^[11] Por edhe sikur hartuesit e peticionit ta kishin bërë një gjë të tillë, problemi do të mbetej po i njëjti: të kërkohej korrigjimin e një teksti të shenjtë do të thotë të afirmosh relativitetin e çdo shpalljeje fetare. Kjo minon të vërtetën fetare; kjo e sekularizon atë. Të diktosh që normat fetare të jenë në linjë me normat sekulare është problematike në një demokraci liberale, pasi një gjë e tillë mohon faktin se feja është religjioze (qeveria kineze, që zbaton këtë parim pa dallim për myslimanët dhe katolikët e vendit, nuk e ka një problem të tillë).

Rregullimi burokratik

Një tjetër dimension më diskreti sekularizimit ka të bëjë me rregullimin, dhe shpaloset veçanërisht në vende që kanë një traditë sekulare të fortë. Në Francë, për shembull, ligji i vitit 2004 që ndalon simbolet e dukshme fetare në shkolla është interpretuar me një zell të tepruar, me fundet që janë interpretuar si tejet të gjatë dhe bandanat [shamitë sportive që mbahen në kokë sh.p.].^[12] që janë trajtuar si shenja fetare (mjekrat i kanë shpëtuar ndalimit për shkak se hipsterët japin atyre

kredenciale sekulare). Pothuajse gjithçka rrezikon që të shihet si fetare. Burkini, që nuk gjendet askund në Kuran apo në hadithet e Profetit, apo madje edhe në plazhet e Arabisë Sauditë, trajtohet si shenjë fetare, siç ndodh edhe me mos-ngrënien e mishit në mensat e shkollave. Obsesioni me fenë bën që feja të shihet kudo, duke rezultuar në rregullime të tej mase të zellshme.

Një shembull interesant mund të gjendet në burgjet franceze. Ligji i vitit 1905 mbi Ndarjen e Kishës nga Shteti e detyron shtetin që të emërojë kapelanë në burgje. Kur në dekadën e parë të mijëvjeçarit të ri u bë e qartë se burgjet ishin bërë një vatër e radikalizimit islamik, administrata e burgjeve ra dakord për futjen e prezencës së kapelanëve myslimanë. Por, njëllonj si të gjithë kapelanët tjerë, ata nuk e kishin të lejuar që të kontaktonin të burgosurit me inisiativën e tyre, nga frika se kapelanët do të prozelitizonin. Kjo nuk ka shumë kuptim, duke qenë se arsyeja përse fillimisht u kërkuan shërbimet e kapelanëve myslimanë ishte që ofrohej një alternativë ndaj konvertimeve të të burgosurve në Selefizëm. Rezultati është se, në emër të laicitetit, dhe për shkak të frikës së prozelitizimit, kapelani supozohet të presë në zyrën e tij që të vijë një i dënuar e të bëjë një kërkesë të shkruar për t'u takuar me të, gjë që sigurisht ndodh shumë rrallë. Ndërkohë, Islami radikal shtohet nëpër burgje, i përhapur nga vetë të burgosurit.

Intensiteti i praktikës fetare cilësohet shenjë e radikalizimit, siç është evidente kjo në udhëzimin për pikasjen e sjelljes radikale botuar nga qeveria franceze në shkurt të vitit 2018.^[13] Në krahun tjetër, shkëlja e normave fetare shihet si shenjë moderimi: “Ai është mysliman, por pi alkool” përdoret shpesh një argument për të vërtetuar se një aplikant për një vend pune nuk është ‘radikal’. Myslimanë të shumtë aplikojnë për t'u bërë transportues bagazhesh në aeroportin Charle-de-Gaulle, duke pasur parasysh afërsinë me Seine-Saint-Denis që ka komunitete të mëdha arabe dhe sub-saharane, dhe kështu, kur policia kryen një hetim për të miratuar lejene tyre të sigurisë, njëra nga pyetjet e para ka të bëjë me praktikën fetare. Mënyra më e mirë për të kaluar intervistën pa vështirësi është që të përmendet spontanisht konsumi i alkoolit: njëra nga rastet e rralla kur pirja e alkoolit e bën më të lehtë marrjen e një vendi pune.

Të gjitha këto raste tregojnë se si sekularizmi po çrrënjos madje edhe shenjën më të lehtë të religjiozitetit nga arena publike, se si kontribuon për të zbrazur hapësirën publike nga çdo spiritualitet, por gjithashtu e deklaron fenë jo në sferën private (ku, me përkufizim, ajo e ka vendin), por në margjina, ku ajo fare lehtë mund të bjerë në duart e radikalëve.

Mbrojtja e identitetit të krishterë: një kontribut për sekularizimin

Në disa rrethana, gjykatava u është kërkuar që të përcaktojnë nëse duhet bërë një argumentim për *eksepcionalizmin* e krishterë. Kjo jo vetëm që do të konfirmonte se parimi i lirisë fetare nuk nënkupton barazi të feve, por do të theksonte gjithashtu se Krishterimi është një pjesë integrale e kulturës dominante të Europës, duke nënkuptuar se prania e tij në sferën publike do të ishte një çështje e sigurtë, pavarësisht nga feja dhe praktika fetare e evropianëve.

Është e qartë se sot ka pabarazi ndërmjet feve në Europë, por kjo gjithashtu reflekton historinë, kulturën e së shkuarës dhe demografinë. Autoritetet myslimane zakonisht ndjekin modelin e bashkësive judaike, të cilat kanë përqaftuar statusin e tyre si pakicë. Asnjë besimtar nuk kërkon që një gjysmëhënë apo ylli i Davidit të vendoset në krah të çdo kryqi që shfaqet në publik apo që ditët e pushimeve zyrtare të përfshijnë çdo festë fetare apo që vende të krishtera të rimerëtohen^[14] (ndryshe nga anti-racitët, të cilët argumentojnë për ndryshimin e emrave si pjesë e “dekolonizimit” të ndërtesave dhe hapësirave publike). Më saktë, kërkesat për barazi vijnë nga qarqet multikulturaliste, të

cilat janë ekuivalenti demokratik i identitarianëve populistë.^[15] Të dyja grupet i shohin shenjat fetare si shënjes kulturorë, që është arsyeja përse të parët këmbëngulin mbi barazinë ndërmjet simboleve dhe të dytët këmbëngulin mbi supremacinë e simboleve të krishtera. Bëhet fjalë për një kërkesë thellësisht sekulare në atë se ajo i jep rëndësi të barabartë gjithçkaje që bën brenda sferës fetare, duke flakur kështu tutje pikëpamjen e të besimtarëve të çdo bindjeje, për të cilët simbolet fetare kanë të bëjnë me transhendencën dhe jo me imanencën, dhe me të shenjtëruarën dhe jo me mundanën, apo këso-botësoren. Megjithatë, shqyrtimi i jurisprudencës dhe vendimeve nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut tregon se sa herë që Gjykata mbron trajtimin e barabartë të feve në favor të Krishtërit, ajo e bën këtë gjithmonë duke e reduktuar shenjën e krishterë në një shënjes pastërtisht kulturor.

Velloja myslimane dhe velloja e murgeshës

Në rastin e Fersheta Ludin, një mësuese së cilës iu mohua një vend pune në Shtutgart në vitin 1998 për shkak ajo mbante veshur një shami, në fund të procedimeve të ndërlikuara gjyqësore, parlamenti në Baden-Vyrtemberg miratoi një ligj që mandatonte neutralitet politik dhe fetar për mësuesit, por që bënte përjashtime për “besimin e krishterë dhe besime të tjera tradicionale perëndimore”.^[16] Një mësuese murgeshë mund ta mbante veshur vellon e saj, por një mësuese myslimane duhet ta hiqte shaminë. Gjykata Kushtetuese Federale e Gjermanisë përfundimisht e rrezoi këtë gjykim juridik, por arsyetimi i parlamentit përdoret ende mjaft shpesh për të vendosur kufizime mbi Islamin, si një “fe” e huaj. Sikundërse e kemi diskutuar, problemi është vlerat e krishtera dhe vlerat perëndimore nuk përkojnë më me njëra tjetrën. Kjo shpjegon referencën e mjegullt ndaj “traditave kulturore”, a thua se vlerat e krishtera përkufizohen vetëm si shënjes kulturorë.

Minaret në Zvicër

Në nëntor të vitit 2009, qeveria zviceriane miratoi një ligj që ndalonte ndërtimin e minareve, dhe kjo në vijim të rezultateve të një referendumi. Padyshim, rasti në fjalë do të shkojë edhe në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut herët a vonë. Duke qenë se kushtetuta zviceriane garanton lirinë fetare, e vetmja mënyrë për të ndaluar minaretë është që ato të paraqiten si kulturore dhe si jo-thelbësore për ritet e adhurimit. Të paktën kësaj here, është kështu: minaret, të cilat nuk kanë ekzistuar në kohën e Muhamedit, u frymëzuan fillimisht nga kambanoret e krishtera. Ato nuk janë kurrësi një aspekt thelbësor i kryerjes së obligimeve fetare. Të gjitha obligimet rituale të fesë mund të plotësohen pa minare, dhe xhamitë pa minare nuk preken nga ndalimi, kështu që nuk ka asnjë shkelje të lirisë fetare. Ndalimi mbi minaretë si objekte ‘kulturore’ justifikohet me arsyetimin se ato bien ndesh me arkitekturën dhe peizazhin zvicerian, aspekte këto të kulturës zviceriane. Argumenti i shtetit zvicerian ndihmon që Islami të dekulturnizohet dhe kështu, paradoksalisht, e bën atë më të pajtueshëm me Europën. Nuk mund të ndërtohen më xhami turke në Zvicër, por asgjë nuk e ndalon tashmë ndërtimin e xhamive zviceriane (me kullë sahati, për shembull). Rrjedhojë tjetër është se Islami nuk krahasohet me Krishtërimin si fe, por me një estetikë kulturore perëndimore, e cila, siç e kemi parë, është në shumë aspekte në kundërshtim me normat e krishtera. *Jodeli(jololehihi-ja e malësorëve gjermanikë jugorë)* në vend të ezanit: ku e ka *kitsch*-i limitin e fundit? Sërish, sekularizohet Krishtërimi për të luftuar Islamin.

Çështja e kryqit^[17]

Në Italinë e viteve 1950, situata politike dhe sociale ishte ekstremisht e polarizuar, siç ishte në Francë, me një parti të fortë komuniste, një parti demo-kristiane dhe dy shoqëri civile gjegjëse. Kryqet mund të shiheshin në klasat e shkollave. Asnjë zyrtar i zgjedhur komunist nuk ka kërkuar ndonjëherë që ato të

hiqen. Duhej një ateiste finlandeze, e shqetësuar për ndikimin e dëmshëm të kryqit mbi të birin e saj, që çështja të përfundonte para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në vitin 2009. Argumenti ishte se prezenca e kryqit ishte në vetvete një formë prozelitizmi. Për të justifikuar praninë e kryqit, avokatët e qeverisë italiane e përkufizuan atë thjesht si një simbol kombëtar të kulturës italiane, me argumentin se nuk mund të sendërtohej se përbën prozelitizëm duke qenë se nuk ka aspak të bëjë me fenë. Në sytë e qeverisë italiane, në thelb kryqi është shndërruar thjesht në një dru të gdhendur me përmbajtje kulturore. Shteti fitoi, por peshkopët u shqetësuan me të drejtë që një simbol fetar mund të përngjasehej kësisoj me një objekt kulturor.^[18] Sërish, kauza e kryqit u fitua, por gjatë këtij procesi feja u sekularizua. Kësisoj, ose favorizohet kultura dhe sakrifkohet feja, ose feja merr përparësinë dhe kultura bëhet irelevante. Si në rastin e skenave të lindjes së Krishtit në Francë,^[19] transformimi i kryqit në një objekt kulturor don të thotë se ne nuk jemi duke folur me për fe.

Feja dhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut

Në përmbledhjen e mësipërme të vendimeve të Gjykatës Evropiane, është e qartë se në rastet që përmbajnë problematika fetare, Gjykata aplikon në masë dërrmuese parimin e subsidiaritetit, domethënë, duke u lejuar shteteve që të trajtojnë të gjitha çështjet që ato janë në gjendje të manaxhojnë pa asistencën e një autoriteti më të lartë në nivel evropian. Si rrjedhojë, Franca mund të ndalojë burkën – një ligj ky që, sipas Gjykatës, përbën një shkelje të lirisë fetare – për shkak se koncepti i “të jetuarit të sëbashku” është një element i kulturës franceze, sikurse është laiciteti.

Një fe, në këtë rast Krishtërimi, mund të ketë përparësi vetëm në qoftë se ajo korrespondon me kulturën mbizotëruese (*Leitkultur*). Kështu, Gjykata e ka ratifikuar fenë si një aspekt të kulturës kombëtare dhe është përmbajtur nga dhënia e një përkufizimi të përgjithshëm për lirinë fetare. Si ndalimi i burkës në Francë ashtu dhe tolerimi i kryqit në Itali justifikohen mbi bazën e “kulturës kombëtare”: francezët janë sekularistë dhe italianët janë katolikë. Në emër të parimit të subsidiaritetit,^[20] Gjykata jo vetëm që e refuzon idenë që Europa është e krishterë, por gjithashtu refuzon idenë e një kulture dominante fetare në Europë duke ua atribuar si fenë ashtu dhe sekularizmin kulturave kombëtare. Duke reduktuar fenë në kulturë, ajo e sekularizon atë.

Vendimi i Gjykatës Evropiane i 23 tetorit 2018 (*E.S. kundër Austrisë*), që la në fuqi dënimin nga ana e gjykatës austriaketë një gruajë e cila e quajti Profetin Muhamed “pedofil”, përmbledh perspektivën e Gjykatës. GJEDNJ (ECHR) dha tre argumente në linjë me shembujt e dhënë këtu: 1) sipas parimit të subsidiaritetit, çdo vend ka të drejtën për të pasur legjislacionin e tij në lidhje me fenë, një argument ky që ruan kontrollin politik mbi sferën religjioze; 2) është detyra e shtetit që të garantojë harmoninë sociale dhe bashkëjetesën paqësore midis grupeve, dhe rrjedhimisht të kontrollojë “nxitjen e urrejtjes”; 3) akuza e bërë nga e akuzuara fyente ndjenjat religjioze të besimtarëve.

Pa ringjallur aspak krimin e blasfemisë (të cilin ajo shprehimisht e refuzoi), Gjykata shpërfilli qëllimisht dimensionin e shenjtë të fesë; madje ajo e reduktoi fenë në një “ndjenjë” dhe komunitetin e besimit në një kategori të individëve të identifikuar nga një tipar: racë, gjini, apo fe. Kështu, Gjykata e sekularizon sferën fetare duke e vendosur atë në krah të kategorive të tjera profane, dhe, në linjë me Traktatin e Vestfalisë, qeverisjen e kësaj sferë ua beson shteteve sekulare.

Në qoftë se vendi i Krishtërimin në shoqëri po pëson tkurrje, kjo po ndodh për shkak se, krahas tendencës së gjerë të sekularizimit, nevoja për të kufizuar rolin e Islamit shkon deri aty sa të reduktohet roli i sferës fetare në përgjithësi. Në të njëjtën kohë, dëshira për të promovuar identitetin e krishterë si një mjet për të kundërpeshuar rritjen e Islamit rezulton në sekularizimin e shtuar të Krishtërimin.

Sekularistët po ndihmojnë që të çbëhet lidhja midis Europës dhe Krishtërimin, gjë që shpjegon spostimin e tyre drejt politikës së identitetit. Por është mjaft e çuditshme të shohësh intelektuale të krishterë praktikantë që kapen fort pas një Krishtërimi identitar që çkuptimëson vetë spiritualitetin që ata pretendojnë se kultivojnë në zemrat e tyre.

E vetmja gjë që mund të çvleftësojë tezën e zhvilluar këtu, dhe që ka të ngjarë të justifikojë pozicionin e besimtarëve identitarianë, do të ishte një rikthim masiv në besim dhe në praktikën fetare të krishterë, dhe kjo si rezultat i aktivizmit të vazhdojnë të jenë katolikë. Por miratimi i ligjeve dhe imponimi i simboleve fetare, ta bësh tëndin bastin e Paskalit se është më mirë të pretendosh të besosh pasi nuk ka asgjë për të humbur por vetëm fiton duke qëndruar në pritje të ndërhyrjes nga Providenca dhe Shpirti i Shenjtë, nuk është garanci për sukses. Mjaft çuditërisht, këta intelektualë, nga Rod Dreher e deri te Remi Brague dhe Pierre Manent, janë thellësisht pesimistë, për shkak se ata janë esencialistë; ata ngatërrojnë kulturën me fenë, dhe nuk arrijnë të shohin se të dyja ato janë në krizë, apo së paku janë duke evoluar. Ndoshta, ndërkohë që pritet ardhja e Shpirtit të Shenjtë, do të ishte më mirë që të rikuperohej lehtësia e papërbalueshme e qenies. Në qoftë se Europë do të bëhet sërish e krishterë, ajo ka nevojë për profetë, e jo për ligjvënës. Por, fare mirë mund të rezultojë se profetët nuk janë atje ku pritet të gjenden.

Përktheu: Arjol Guni

[1] Kurse trajtinimi në sekularizëm për imamët, organizuar nga Institut Catholique i Parisit. S'është nevoja të thuhet se ka patur një mungesë të sigurtë të bindjes nga të dyja palët dhe se përpjekja nuk zgjati më shumë se dy vjet.

[2] Olivier Roy, *Globalized Islam: The Search for a New Ummah*, Londër, Nju Jork: Hurst/Columbia University Press, 2004.

[3] *L'Obs*, 22 janar 2004.

[4] Shiko më poshtë.

[5] Marianne Heimbach-Steins, "Religious Freedom and the German circumcision debate", EUI RSCAS, 2013/18, RELIGIOËEST, URL: <http://hdl.handle.net/1814/26335>

[6] *La Croix*, 15 korrik 2012.

[7] <https://www.independent.co.uk/news/world/europe/denmark-bans-halal-and-kosher-slaughter-minister-says-animal-rights-come-religion-9135580.html>

[8] Zanafilla 1, 26 dhe 28.

[9] Christopher Prowse, asqipeshkv i Kanberrës dhe Gulburnit, *Canberra Times*, 6 qershor 2018.

[10] Për gjendjen e diskutimit në Francë, shiko Francis Messner (ed.), *Traite de droit français des religions*, artikuli 1416, Paris: Litec, 2003.

[11] 'Manifeste contre le nouvel antisemitisme,' *Le Parisien*, 21 prill 2018.

[12] Kjo i ka shkaktuar një pakënaqësi të madhe Jean Marie Le Pen, e cila beson se hipsterët po kontribuojnë në tolerancën ndaj Islamizmit në Francë: http://www.youtube.com/watch?v_XqBMX2WfAtk

[13] <https://www.journaldesfemmes.com/maman/ado/1759910-radicalisation-terrorisme-prevention-adolescents>

[14] Në fakt, kongreset e UOIF (Unioni i Organizatave Islamike në Francë) në La Bourget kanë dëshmuar bashkimin e një litanie të re të shenjtoreve katolikë: "Shoqata Islamike e Shën Denisit", "Shoqata luslamike e Shën Pierit", "Shoqata Islame e *Saint-Hilaire-Saint-Mesmin*," etj...

[15] Në dijeninë time, propozimi për të përfshirë festat judaike dhe myslimane në kalendarin zyrtar vjen gjithnjë nga organizata jo-fetare, si Komisioni Stasi (emërtuar sipas Avokatit të Popullit, Bernard Stasi, sh.p.) në vitin 2004, dhe asnjëherë nga komunitetet fetare myslimane apo judaike, që kanë një sens të të shenjtës.

[16] Shiko Ruben Seth Fogel, "Headscarves in German Public Schools", *New York Law School Law Review*, vol. 51, no. 3, 2006-2007.

[17] Shiko Frederick Mark Gedicks dhe Pasquale Annichino, "Cross, Crucifix, Culture: An Approach to the Constitutional Meaning of Confessional Symbols", EUI RSCAS, 2013/88; RELIGIOWEST, <http://cadmus.eui.eu/handle/1814/29058>

[18] <https://ëëë.lastampa.it/vatican-insider/it/2018/03/18/neës/il-papa-la-croce-non-e-ornamento-o-un-açessorio-d-abbigliamento-1.33993744>

[19] Shiko më poshtë.

[20] Parimi i subsidiaritetit është i pranishëm edhe në traditën e krishterë, gjendet te protestantët e shekullit të gjashtëmbëdhjetë si edhe në enciklikën *Rerum novarum* të vitit 1891 dhe enciklikat e mëpasme sociale.

Date Created

21/01/2021

Author

olivier-roy